



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –DRAGASH
OPSTINE DRAGAS
MUNICIPALITY OF DRAGAS



Kryetari i Komunës – Dragash

02 Nr. 390/16-23101/16

Dt.11/09/2026

Në bazë të nenit 13 e 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), neni 18 i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 01 Nr.060/01-31587/1 e dt.24.12.2019, neni 57 të statutit të Komunës së Dragashit Nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

I

OBLIGOHET Drejtoria për Bujqësi, Turizëm, Inspeksion dhe Zhvillim Rural që brenda afatit ligjor të përgatit dhe shpall thirrjen publike për Organizimin e panairit me produkte vendore lokale.

II

Për zbatimin e vendimit përkujdeset Drejtoria për Bujqësi, Turizëm, Inspeksion dhe Zhvillim Rural e Komunës së Dragashit.

III

Për veprimet e mëtejshme të njoftohet kryetari i Komunës.

IV

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtoria për Bujqësi, Turizëm, Inspeksion dhe Zhvillim Rural
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –DRAGASH
OPSTINE DRAGAS
MUNICIPALITY OF DRAGAS



Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural
Direktoriat za Poljoprivredu, Sumarstvo, Inspekciju, Turizam i Ruralni Razvoj

09.Nr. 320/01-23132/26
Dt. 11/09/2026
Dragash

Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural bazuar në vendimin e kryetarit të komunës me numër 02.Nr. 390/01-23101/26 të datës 11/09/2026 si dhe duke u bazuar në Rregulloren komunale nr. 01Nr.060/01-31587/1 të datës 24.12.2019 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve :

Thirrje publike

Organizatat Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i se cilave është i fokusuar në mbështetje të bizneseve vendore dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit të aplikojnë për mbështetje financiare për organizimin e aktivitetit:

Organizimi i Panairit me produkte vendore lokale

Qëllimi i organizimit të këtij panairi është prezantimi i prodhimeve bujqësore-blegtorale dhe artizanale, prezantimi i produkteve vendore-lokale të rajonit tonë, në mënyrë që qytetarët të njihen me këto prodhime dhe më cilësinë e tyre, t'u ofrohet mundësia bizneseve lokale-vendore të promovojnë produktet e tyre në mënyrë që të rrisin pjesëmarrjen e tyre në treg si dhe të bëjë që konsumatorët të njihen me produktet e reja dhe ato ekzistuese.

Ky aktivitet është në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore komunale dhe i cili do të kontribuon drejtpërdrejt në zhvillim të qëndrueshëm rural.

Objektivat:

- Te ndikojë në përmirësimin e gjendjes së promovimit të produkteve tradicionale të vendit,
- Te sensibilizohet popullata për produktet tradicionale vendore dhe cilësinë e tyre.
- Qasje direkte me konsumatorët
- Takime me kompanitë vendore dhe ndërkombëtare
- Marketing dhe shitje direkte pranë vizitorëve
- Promovim direkt përmes mediave elektronike dhe të shkruara për produktet lokale

Përfituesit:

Përfitues në mënyre të drejtpërdrejtë do të jenë fermerët, prodhuesit lokal dhe prodhuesit e produkteve tradicionale të Komunës së Dragashit ku ata do të ekspozojnë produktet e tyre, kurse në mënyrë indirekte komuniteti në përgjithësi ku do të kenë rastin të njoftohen me produktet vendore-lokale dhe produktet tradicionale të Sharrit.

Pjesëmarrësit

Në këtë panair janë planifikuar të marrin pjesë këta pjesëmarrës:

- Prodhues të Djathit,
- Fermer prodhues tradicional të djathit të Sharrit,
- Prodhues të mjaltit,
- Promovues të turizmit (me kinoprojektor, materiale të tjera promovuese, etj)
- Grumbullues-përpunues të bimëve mjekuese-fruta malore
- Prodhues të artizanatëve të ndryshme tradicionale vendore (veshje tradicionale, vegla, instrumente etj)
- Përpunues të mishit (produkte tradicionale si : sugjuk, qebapa sharri etj)
- Prodhues të tjerë lokal-vendor

Buxheti

Për organizimin – mbajtjen e Panairit me produkte vendore-lokale është planifikuar buxhet: **13000 (trembëdhjetë mijë) euro.**

Lokacioni:

Aktiviteti do të organizohet në **Dragash, në Shkollën e Mesme Profesionale “Fisnik Ibrahim” - te Mejdani i Shajnës.**

Aktivitetet që do të kryhen:

- Të bëhet pastrimi i oborrit (kositja dhe pastrimi), pastrimi i ambienteve të brendshme dhe pastrimi pas përfundimit të panairit,
- Përgatitja e vendit për mbajtjen e panairit dhe të ju krijohen kushte pjesëmarrësve që para fillimit të panairit t'i vendosin produktet e tyre,
- Hapja e panairit me valle tradicionale nga komunitetet,
- Të ndihmohen financiarisht të gjithë aplikantët për pjesëmarrje në panair (shpenzime minimale 30 euro e më shumë) dhe të mos refuzohet asnjë aplikant që donë të merr pjesë me produktet e tije,
- Përfituesi i thirrjes publike duhet të përgatit materialët promovuese : banerin me mbishkrime (Panairi me produkte vendore lokale 2026) me dimensione 4 m/1.5m, në të dy gjuhët, me **logo të komunës** dhe të shkruhet financuar nga Komuna e Dragashit si dhe të përgatit dy rollera me të njëjtin mbishkrim si të banerit,
- Panairi të jetë i hapur se paku 8 orë (një ditë),

- Të njoftohen mjetet e informimit tv, radio etj,
- Të shpërndahet ne rrjetët sociale, web faqën e komunës etj,
- Të ftohën zyrtarisht donatorët-organizata e jashtme qe kanë financuar apo mbështetur me projekte të ndryshme në Komunën e Dragashit.

Organizatat përfituese:

Përfitues do të jetë **një Organizatë Jo-Qeveritare.**

Kushtet për aplikim:

- Të drejtë të aplikimit kanë OJQ-të, që janë te regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e komunës së Dragashit dhe të cilat merren me aktivitete në përkrahje të bizneseve lokale te Komunës se Dragashit,
- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e aplikimit,
- Ojq-të te kenë të kryer transaksione financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe te kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndajë komunës së Dragashit,
- Propozimi-Aplikacioni duhet të dorëzohet i detajuar në formularët e paraparë të cilët bashkë me udhëzimet për aplikant janë në dispozicion në webfaqën e internetit të Komunës së Dragashit.
- Do të konsiderohen për tu vlerësuar vetëm projektet e dorëzuara brenda afatit të paraparë me thirrje publike.
- Koha dhe mënyra e ankesave i gjeni të detajuara në udhëzimet për aplikant të thirrjeve publike.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni-projekt propozimi,
- Formulari i propozim buxhetit (specifikacioni),
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (sipas rregullores nr.04/2017- Financimi i OJQ-ve-MF –neni 10 paragrafi 1.4 dhe 1.5),
- Formulari për konflikt interesi (sipas rregullores nr.04/2017- Financimi i OJQ-ve-MF – neni 10 paragrafi 1.4 dhe 1.5),
- Dokumenti i identitetit i aplikuesit (fotokopje),
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje),
- Konfirmimi bankar i OJQ-së,
- Të specifikohen agjenda e aktiviteteve,
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK (periudha e fundit tatimore),
- Dëshmi te implementimit të projekteve/programeve të ngjashme,
- Dëshmi për kryerjen e obligimeve paraprake nga mbështetja financiare publike.

Vlerësimi

Vlerësimi do të bëhet nga komisioni profesional prej 5 anëtarësh, të cilët do të i vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, kriteret për procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Po ashtu vlerësimi do të bëhet edhe sipas:

- Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit
- Ndërlidhja me objektivat e thirrjes
- Kapaciteti i dëshmuar organizativ dhe menaxhues
- Cilësia dhe origjinaliteti i projektit
- Buxheti i specifikuar dhe real.

Kohëzgjatja e aplikimit

Aplikimi do të filloj më datë **11 /09/2026** deri më **25/09 /2026 (15 ditë)**.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e protokollit (Arkivi) Nr.1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit, për: Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural.

Për sqarim mund të na kontaktoni në DBPITZHR.

Drejtori
Enes Goran

